


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3224 Rep.
Nr. 888 Kol.



KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Sot, me daten 6/4/2006 ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje **Noteres Mimoza Shehu** u paraqiten personalisht te interesuarit si me poshte me cilesine e shitesit dhe blesesit te cilet ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil si dhe te Ligjit "Per shoqerite tregtare" kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

SHITESI: Arian Llalla, i biri i Kujtimit, dtl.1966, banues ne Tirane, perfaqesuar me prokuren nr.912 rep,nr.273 kol dt.3.2.2006 nga Tomson Capoi(Xhelili), madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i njohur personalisht prej meje Noteres.

DHE

BLERESE: Rovena Luga, e bija e Tomorit, dtl.1977, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e njohur personalisht prej meje Noteres.

OBJEKT: Transferimin e pjesshem te kuotave te shoqerise "Calvin Vizion" sh.a qe i perkasin Z.Arian Llalla ne mbeshtetje te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" neneve 62,63 dhe neneve te Statutit te shoqerise tregtare "**CALVIN VIZION**" sh.a.

*Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne ditën e sotme te shoqerise "**CALVIN VIZION**" sh.a shoqeri kjo e regjistruar si person juridik me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr.22575 date 13.1.2000.*

Aksioneret e shoqerise "**CALVIN VIZION**" sh.a zoterojne :
Z.Arian Llalla me 50 % te aksioneve te kapitalit.
Z.Tomson Xhelili me 50 % te aksioneve te kapitalit.

Ne mbeshtetje te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" nenit 62,63 dhe neneve perkates te Statutit te shoqerise tregtare "**CALVIN VIZION**" sh.a shitesi dhe bleresi bien dakort midis tyre per shitjen e kuotave si me poshte vijon:

1) Shitjen e pjeseve te kapitalit te shoqerise me menyren si vijon:

Z.Arian Llalla i cili zoteron 50% te aksioneve te kapitalit te shoqerise ia shet keto aksione Znj.Rovena Luga kundrejt shumes 50.000(pesedhete mije)USD e cila nga ana e saj deklaroi se eshte dakort per blerjen e tyre.

Perfundimisht aksionere te kesaj shoqerie do te mbeten Z.Tomson Xhelili dhe Znj.Rovena Luga te cilet zoterojne nga 50% te aksioneve secili.

Nga ky moment ata marrin persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga administrimi i kesaj shoqerie.

Kontrata si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te paleve nenshkruhet vullnetarisht ne prani te noteres nga shitesi dhe bleresi dhe une noterja legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

Kontrata u redaktua ne tre kopje me fuqi te barabarte secila,ku njera prej tyre arkivohet ne kete zyre noteriale.

**BLERESE
ROVENA LUGA**

Rovena Luga



**SHITESI
ARIAN LLALLA
Perfaq Tomson Capoi(Xhelili)**

Tomson Xhelili

